Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

United Nations ALBANIA

UNDP
Empowered lives.
Resilient nations.

BASHKIA BELSH

# PLANI SOCIAL I BASHKISË BELSH 2024-2027

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

United Nations
ALBANIA

UNDP

Empowered lives.
Resilient nations.

*Përgatitja e Planit Social të Bashkisë Belsh u mundësua nga mbështetja e Programit "Leave No One Behind" i Kombeve të Bashkuara. Ky program është i angazhuar për të mbështetur reformën e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Shqipëri në përgjigje të përpjekjeve të qeverisë shqiptare për të mundësuar përfshirjen sociale të grupeve në nevojë. Në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë qendror programi LNB po mbështet Bashkitë për të zhvilluar, zbatuar dhe monitoruar Planet Sociale Lokale. Ligji nr. 121/2016 "Mbi shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" ngarkon Bashkitë me detyrën e përgatitjes së këtyre Planeve bazuar në nevojat e identifikuara për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e tyre.*

Leave No One Behind

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

United Nations ALBANIA

UNDP
Empowered lives.
Resilient nations.

# PËRMBAJTJA


HYRJE ........ 6

1. MISIONI, VLERAT DHE PARIMET UDHËRRËFYESE ........ 7

1.1 Vizioni ........ 7

1.2 Misioni ........ 7

1.3 Vlerat, parimet, dhe synimet ........ 7
1.3.1. Vlerat ........ 7
1.3.2. Parimet udhërrëfyese ........ 7
1.3.3. Synimet ........ 8

2. METODOLOGJIA F HARTIMIT TË PLANIT ........ 8

3. ANALIZA E SITUATËS ........ 9

3. 1 Kuadri Strategjik ........ 9

3.2 Situata socio-ekonomike ........ 13
3.2.1 Veçoritë fizike dhe mjedisore ........ 13
3.2.2 Të dhëna demografike ........ 13
3.2.3 Arsimi ........ 14
3.2.4 Ekonomia ........ 15
3.2.5 Punësimi dhe papunësia ........ 15
3.2.6 Shëndetësia ........ 17

3.3 NEVOJAT PËR SHËRBIME SOCIALE TË GRUPEVE VULNERABËL DHE ATYRE NË RISK ........ 17
3.3.1 Familjet e varfra ........ 17
3.3.2 Personat me aftësi të kufizuar ........ 19
3.3.3 Mbrojtja dhe përkujdesja për fëmijët ........ 20
3.3.4 Dhuna në familje ........ 21

3.3.5 Strehimi .......... 23
3.3.6 Të moshuarit e vetmuar .......... 23
3.3.7 Divorcet .......... 24
3.3.8 Varësia nga alkooli .......... 24
3.3.9 Emigrantët e kthyer .......... 25

**3.4 Vlerësimi i Shërbimeve Aktuale .......... 26**
3.4.1 Shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë .......... 26
3.4.2 Shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Qarkut Elbasan .......... 28

**4. VLERËSIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE, NJERËZORE, DHE FINANCIARE PËR TË OFRUAR SHËRBIME SOCIALE .......... 28**

**4.1 Organizimi i strukturave të shërbimeve të kujdesit shoqëror .......... 28**

**4.2 Organizimi në përputhje me ligjin .......... 29**

**4.3 Shërbimet ekzistuese të përkujdesit shoqëror .......... 30**

**4.4 Financimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror .......... 31**

**4.5 Shoqatat dhe shërbimet që ofrojnë në territorin e bashkisë Belsh .......... 33**

**5. ANALIZA SWOT .......... 36**

**6. FUSHAT, QËLLIMET, DHE OBJEKTIVAT E PLANIT SOCIAL .......... 36**

**SHTOJCA 1: PLANI I VEPRIMIT .......... 0**

**SHTOJCA 2: MONITORIMI DHE VLERËSIMI .......... 13**

**SHTOJCA 3: KOSTIMI DHE HENDEKU BUXHETOR .......... 15**

**SHTOJCA 4: SHPORTA E SHËRBIMEVE SHOQËRORE .......... 15**

**REFERENCA .......... 18**

## Hyrje/Përshëndetje nga drejtuesja e sektorit.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

United Nations ALBANIA

UN DP

Empowered lives. Resilient nations.

# HYRJE

Duke konsideruar detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar, por edhe situatën e grupeve në nevojë në territorin e saj, Bashkia Belsh konsideron të rëndësishëm planifikimin strategjik për shërbimet e kujdesit shoqëror. E mbështetur nga programi "Leave No One Behind" i Kombeve të Bashkuara, struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashkinë Belsh nisi në Korrik 2023 procesin e hartimit të Planit Social Vendor.

Plani Social paraqet prioritetet e bashkisë Belsh në fushën e zhvillimit social për periudhën 2024-2027. Në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore," në nenin 24 përcaktohet se: "Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale, të cilat fokusohen veçanërisht në krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, etj." Gjithashtu, në Ligjin 121/2016 "Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", në nenin 36 "Roli i Bashkisë" përcaktohet se: "njësitë e qeverisjes vendore kanë përgjegjësinë për të planifikuar dhe buxhetuar shërbimet e përkujdesit social bazuar në vlerësimin e nevojave, identifikimin e burimeve financiare dhe partneriteteve vendore, bashkia harton planin e kujdesit social vendor."

Në përputhje me vlerësimin e nevojave për shërbime në territorin e saj të identifikuara përmes të dhënave të mbledhura mbi individët dhe grupet në nevojë, diskutimet me stafin dhe aktorët e tjerë, si dhe shportën bazë të shërbimeve të kujdesit shoqëror, Bashkia Belsh identifikoi dhe planifikoi përmes masave konkrete prioritetet për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e saj, pjesë e Planit Social 2024-2027.

Plani Social është bazuar në qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato lokale, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale. Ai shoqërohet gjithashtu me Planin e Veprimit (2024-2027), i cili është i ndarë në pesë fusha kryesore:

1. Qasja në shërbime sociale
2. Trajnim dhe punësim
3. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
4. Shërbime Parandaluese
5. Burimet njerëzore

Gjatë periudhës 2024-2027, bashkia Belsh do ta përqëndrojë vëmendjen e saj në përmbushjen e qëllimeve të mëposhtme:

- Përmirësimi i qasjes në shërbime sociale përmes rritjes së numrit dhe llojeve të shërbimeve që ofrohen në territorin e bashkisë Belsh.
- Zbutja e papunësisë përmes ofrimit të kurseve profesionale.

- Ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm të mbrojtjes së fëmijëve përmes fuqizimit të kapaciteteve të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve.
- Zhvillimi i shërbimeve parandaluese.
- Përgatitja e stafit për t'ju përgjigjur ndryshimeve ligjore dhe kërkesës në rritje për shërbime sociale efektive.

Në mënyrë të ngjashme me procesin e hartimit, zbatimi, monitorimi, dhe vlerësimi i Planit Social do të realizohen në bashkëpunim me aktorë lokalë, rajonalë, kombëtarë, dhe ndërkombëtarë.

# 1. Misioni, vlerat dhe parimet udhërrëfyese

## 1.1 Vizioni
Sigurimi i mundësisë së përdorimit të shërbimeve sociale cilësore për të gjithë qytetarët në nevojë në përputhje me nevojat e tyre në çdo njësi administrative të Bashkisë Belsh.

## 1.2 Misioni
Nëpërmjet këtij plani, Bashkia Belsh do të garantojë shërbime të kujdesit shoqëror me cilësi të lartë në bashkëpunim me OJQ-të dhe sektorin privat për të përmirësuar jetën e fëmijëve dhe të të rriturve, të përjashtuar dhe/ose në rrezik përjashtimi, duke siguruar mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin shoqëror të tyre.

## 1.3 Vlerat, parimet, dhe synimet
### 1.3.1. Vlerat
Plani Social i Bashkisë Belsh përgjatë realizimit të misionit do të ndihmojë në:

- Ngritjen e kapaciteteve institucionale që ofrojnë shërbime të integruara dhe të veçanta për individë dhe grupe në nevojë kritike, si në komunitet ashtu dhe në familje;
- Sigurimin e bashkërendimit dhe bashkëpunimit midis qeverisë qendrore, pushtetit vendor dhe rrjetit të organizatave jofitimprurëse;
- Fuqizimin e institucioneve të pushtetit vendor, sidomos në drejtim të identifikimit të personave "në nevojë" ose "të rrezikuar" si dhe të vendimmarrjes mbështetur në parimin e interesit më të mirë të qytetarit dhe të respektimit të të drejtave sociale;
- Zbatimin e praktikave të mira dhe të modeleve të përparuara të financimit të shërbimeve sociale;
- Përmirësimin e legjislacionit të shërbimeve sociale duke synuar sigurimin e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të individëve dhe grupeve në nevojë.
- Vëzhgimin/mbikqyrjen e zbatimit të standardeve të miratuara të shërbimimeve sociale, pavarësisht nga format dhe tipologjitë e shërbimeve.

### 1.3.2. Parimet udhërrëfyese
Hartimi i Planit Social të Bashkisë Belsh udhëhiqet nga parimet që vijojnë:

- Respektimi dhe garantimi i të drejtave për mbrojtje dhe siguri sociale në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni kombëtar;
- Nxitja e pjesëmarrjes të grupeve përfituese dhe grupeve të tjera të interesit përgjatë procesit të hartimit të planit si edhe të monitorimit të zbatimit të tij;
- Fuqizimi në nivel personal dhe komunitar i individëve në nevojë, duke realizuar integrimin dhe përfshirjen e tyre në aktivitete ekonomike e sociale;
- Zbatimi i politikave lokale të mbështetura në parimet e mbrojtjes të interesit më të mirë të fëmijës dhe të respektimit të barazisë gjinore;
- Ndërtimi i politikave lokale në përputhje me kompetencat vendore që rrjedhin nga Ligji mbi Reformën Territoriale.
- Garantimi i aksesit të barabartë tek shërbimet shoqërore;
- Ofrimi i shërbimeve shoqërore të ndërtuara mbi parimin e de-institucionalizimit;
- Ndërtimi i shërbimeve të qëndrueshme nga pikëpamja financiare dhe kosto-efektive.

### 1.3.3. Synimet

Me qëllim që të hartohet një system shërbim efektiv dhe në përputhje me nevojat e qytetarit, është e nevojshme që ndërhyrja publike të përfshirjë kërkesën (qytetarin), ofertën (tregun) si edhe mekanizmat ndërmjetës/lidhës (institucionet). Për rrjedhojë, synimet e përgjithshme të Planit Social janë:

- Të sigurojë ndërtimin e një ambienti të përshtatshëm që mbështet dhe ndihmon individët dhe grupet në nevojë kritike për t'u integruar në shoqëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga gjendja e tyre ekonomike, shoqërore, shëndetsore apo autonomia e tyre funksionale, nëpërmjet politikave vendore efektive, në përputhje të plotë me nevojat dhe mundësitë e bashkisë. (institucionet)

- Të sigurojë ndërtimin dhe forcimin e sistemit të kujdesit social në të gjitha njësitë administrative të bashkisë, duke garantuar përdorimin e shërbimeve të larmishme dhe të cilësishme për të gjithë ata që kanë nevojë për kujdes. (oferta e tregut)

- Të mundësojë rritjen e kërkesës për ofrimin dhe funksionimin e shërbimeve efektive, nëpërmjet ndërgjegjësimit të komuniteteve, grupeve të tjera të interesit dhe në veçanti të vetë grupeve në nevojë, nëpërmjet informacionit, këshillimit, konsultimit dhe bashkëpunimit. (kërkesa e tregut)

## 2. Metodologjia e hartimit të planit

Hartimi i planit mbështetet në kombinimin e disa metodave. Së pari, u zhvillua një takim me aktorët lokalë ku u prezantua procesi që do të ndiqej për hartimin e planit dhe u morën sugjerimet e para se ku duhet të fokusohej plani i ri social. Në takim morën pjesë 18 persona, të

cilët përfaqësonin këto institucione: Bashkia Belsh, Sektori Social, Shërbimi Social Shtetëror Elbasan, Njësitë Administrative, Zyra e punës, OJF Diagonia Agapes, FGE, Qendra Shëndetësore, Zyra Vendore Arsimore, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Drejtoria e Emergjencave Civile, Polica, Zyra e Urbanistikës.

Së dyti, Sektori i Mirëqenies Sociale dhe Përkujdesit Shoqëror shpërndau në institucionet lokale dhe rajonale një pyetësor, përmes të cilit u grumbulluan të dhëna rreth zhvillimin social në bashki. Ky informacion u përdor gjatë hartimit të planit.

Së treti, Sektori i Mirëqenies Sociale dhe Përkujdesit Shoqëror zhvilloi një takim të dytë me grupet e interesit—takim i cili u zhvillua në formën e një ushtrimi. Pjesëmarrësit punuan në grupe ku rishikuan fushat, qëllimet, objektivat, dhe aktivitetet e planit të mëparshëm dhe bënë propozime për planin ne ri. Në takim morën pjesë 11 persona (3 burra dhe 8 gra), të cilët vinin nga institucionet e mëposhtme: Zyra Vendore Arsimore, Qendra Sociale dhe Shëndetësore, Zyra e Punës, organizata të shoqërisë civile, Njësi Administrative, dhe në bashki. Pjesëmarrësit mbanin pozicionet e mëposhtme: Drejtor, Koordinator, Punonjëse Sociale, Koordinatore, Oficere Komunikimi dhe Ngritje Fondesh, Inspektore në Njësi Administrative, Menaxhere Projekti, Përgjegjëse Sektori, dhe Psikologe.

Metodologjia është hartuar duke marrë në konsideratë Bashkinë e Belshit si njësi më vete me specifikat e nevojave për shërbime sociale, si dhe me specifikat për zhvillimin e shërbimeve në të ardhmen. Metodologjia ka parashikuar gjithashtu mbledhjen e të dhënave sasiore (aty ku disponohen) për secilin target grup dhe shërbimet sociale që ofrohen.

Nisur nga çështjet dhe pyetjet e mësipërme, ky plan do të fokusohet në:

- Analizën social-ekonomike të Bashkisë Belsh.
- Vlerësimin e kapaciteteve institucionale, materiale, financiare dhe njerëzore të bashkisë, për të ofruar shërbime sociale me standard.
- Vlerësimin e nevojave sociale.
- Evidentimin e modeleve dhe praktikave më të mira të shërbimeve që zhvillohen në territorin e bashkisë.
- Hartimin e një Plani Veprimi për periudhën 2024-2027 për Bashkinë e Belshit në nivel aktivitetesh dhe buxhetimi i masave të planit.

# 3. Analiza e situatës

## 3. 1 Kuadri Strategjik

Politikat lokale në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror e kanë rrënjën e tyre tek politikat dhe standartet kombëtare. **Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020-2023** ka reflektuar angazhimet e Qeverisë Shqiptare në fushën e Mbrojtjes Sociale duke synuar që t'i sigurojë çdo

qytetari shqiptar pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbime publike cilësore. Tre janë politikat[1] e formuluara në këtë strategji mbi të cilat synohet të mundësohet mbrojtje, përfshirje dhe rintegrim social për personat dhe familjet e prekura nga varfëria, si dhe individë në situatë vulnerabiliteti: **(1) Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë; (2) Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara; (3) Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social**.

E përbashkëta e tre politikave qëndron në lidhjen që krijohet tashmë midis programit të pagesave monetare (ndihma ekonomike dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuara) me shërbimet e kujdesit shoqëror të cilat në thelb duhet të luajnë një rol kyç për përmirësimin e cilësisë së jetës së individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë, për fuqizimin dhe riintegrimin e tyre në jetën ekonomike dhe sociale. Specifikisht, në këndvështrimin e programit të ndihmës ekonomike, Strategjia thekson se "Duhen rritur ndërlidhjet e shërbimeve ndaj përfituesve të Ndihmës Ekonomike, në shëndetësi, arsim, strehim, apo tjetër dhe duhet synuar konsolidimi i një pakete të plotë shërbimesh ndaj përfituesve të Ndihmës Ekonomike"[2], duke përcaktuar kështu si një nga ndërhyrjet prioritare masa/shërbime për riintegrimin social të përfituesve të Ndihmës Ekonomike. Një nga objektivat e Strategjisë në këndvështrimin e përmirësimit të cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara është "krijimi i një sistemi shërbimesh integruese që kombinon shërbimet e kujdesit social me pagesat në *Cash*, duke ofruar një paketë të integruar shërbimesh për personat me aftësi të kufizuar deri në 2020"[3]. **Zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social,** Strategjia e sheh të lidhur me zbatimin e parimit të decentralizimit dhe të deinstitucionalizimit. **Synohet ngritja dhe funksionimi i një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit social në njësitë e qeverisjes vendore**. Në vend të shërbimeve rezidenciale synohet ngritja dhe funksionimi i shërbimeve komunitare që i përgjigjen nevojave të identifikuara të individëve e familjeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Çdo fëmijë, apo/dhe i rritur, si dhe familje shqiptare duhet të kenë akses të barabartë dhe të përfitojnë nga një sistem funksional dhe gjithëpërfshirës i shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Bazuar në këtë Strategji, por edhe në Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", sikurse Ligji nr.121, datë 21.11.2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", **Bashkitë janë aktorët kryesorë në ngritjen dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel komunitar dhe si të tilla ato duhet të kenë kapacitetet e nevojshme veçanërisht në drejtim të planifikimit, organizimit, administrimit, dhe kontrollit të këtyre shërbimeve.**

**Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"** në nenin 24 ka përcaktuar funksionet e Bashkisë në fushën e shërbimeve sociale dhe specifikisht: (1) Krijimin dhe administrimin e shërbimeve

---

[1] *Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020-2023, fq.24, aksesuar në https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/12/24/866*
[2] *Idem, Fq.16*
[3] *Idem, Fq.25*

sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. (2) Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. (3) Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. (4) Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

**Ligji nr.121, datë 21.11.2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"** dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij rregullojnë funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe në mënyrë të posaçme procesin e ofrimit të shërbimeve nga organet publike në nivel vendor të ngarkuara sipas Ligjit. Neni 36 i këtij Ligji ngarkon Bashkinë për të ofruar dhe administruar shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj duke: identifikuar nevojat; vlerësuar nevojat në bazë të hartës së vulnerabilitetit; hartuar planin social vendor; programuar buxhetet vendore; planifikuar shportën bazë të shërbimeve shoqërore; kontraktuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik; bashkërenduar me Shërbimin Social Shtetëror shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror.

**Hartimi i Planit Social** nga njësia e qeverisjes vendore është një detyrim që rrjedh nga neni 36 i Ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë". Paketa bazë e shërbimeve të kujdesit shoqëror që rrjedh nga ligji i sipërcituar i vjen në ndihmë Bashkisë në procesin e planifikimit të shërbimeve sipas nevojave për mbrojtje dhe përkujdesje ndaj grupeve vulnerabël. Kjo paketë shërbimesh është konsoliduar përmes **Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 518, date 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar"**. Nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror identifikohen nga Bashkia përmes proceseve konsultuese dhe ato harmonizohen në Planin Social lokal, por shërbimet mund të ofrohen drejtpërdrejtë nga një ofrues publik (Bashkia, Qarku apo SHSSH) ose nga ofrues jopublik. Bashkia duhet të drejtojë jo vetëm procesin e identifikimit të nevojave, por edhe koordinimin e kontributeve që mund të vijnë nga aktorë të ndryshëm publik e jopublik dhe reflektimin e tyre në këtë Plan.

**Financimi i shërbimeve** është parashikuar gjithashtu në ligjin 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" dhe në pikën 2 të **VKM nr. 111, datë 23.2.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social"**, sipas të cilit çdo Bashki ngre Fondin Social, i cili krijohet me burime financiare, nga: (a) *fondet e kushtëzuara që akordohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale; (b) fondet nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të parashikuara për shërbimet shoqërore;(c) të ardhurat nga organizatat jofitimprurëse, individët e bizneset, si dhe donatorë të huaj e lokalë; (ç) tarifat për shërbimet për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror.* Jo vetëm ligji, por edhe ky Vendim i Këshillit të Ministrave i sipërcituar kanë kushtëzuar financimin nga qeveria qendrore të shërbimeve komunitare të Bashkisë me ekzistencën e Planit Social të saj. Ndërkohë **VKM 150, datë 20.03.2019 "Për metodologjinë e**

**llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror"**, ka përcaktuar mekanizmin e financimit nga Qeveria qendrore, si dhe metodologjinë e përllogaritjes së fondeve që do të furnizojnë Fondin Social që ngre Bashkia.

Për të ngritur sisteme komunitare të qëndrueshme të kujdesit shoqëror është e domosdoshme që Bashkia të strukturat e duhura dhe stafe të dedikuara në të dy nivelet e organizimit të saj. Në përputhje me pikat 2 dhe 3 të nenit 36 të Ligjit 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë **bashkive ngrihen struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit.** Analiza e kuadrit ligjor[4] ekzistues të çon në këto role dhe funksione të dy strukturave që duhet të ngrihen e funksionojnë për ta bërë legjislacionin të zbatueshëm:

**(1) Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror, e krijuar pranë Bashkisë,** duhet të sigurojë: **drejtimin strategjik, planifikimin, ngritjen, funksionimin, financimin, monitorimin dhe mbështetjen me kapacitete të sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror.** Ndërkohë kjo strukturë kryen dhe funksione që lidhen me administrimin e pagesave cash të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, sikurse në përputhje **me VKM** Nr.334, datë 17.2.2011 **"Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij"** ka në përbërje të saj edhe koordinatorin vendor për adresimin e dhunës në familje. Në përputhje me **Ligjin nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"**, pjesë e kësaj strukture është edhe Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës, e cila ushtron rolet dhe funksione që rrjedhin nga ky ligj.

**(2) Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit ngrihet[5] në çdo njësi administrative në varësi të Bashkisë,** me përjashtim të Bashkive me më pak së 6 mijë banorë, dhe në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror ajo duhet të përmbushë detyra që lidhen me identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë, menaxhimin e rasteve, referimin tek shërbimet, informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, informim për punësim, për pagesat sociale në të holla; Në përbërje të kësaj Njësie duhet të ketë të paktën: një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6.000 deri në 10.000 banorë; një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për çdo 3000 fëmijë[6]; një administrator shoqëror[7];

[4] *Ligji "Për vetqeverisjen vendore", Ligji 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror", Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005, ndryshuar, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"; Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 (ndryshuar) "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"; Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"*

[5] *Nenet 36 dhe 37 të ligjit 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"*

[6] *Kjo në përputhje me Ligjin "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"*

[7] *Detyra sipas Ligjit "Për ndihmën ekonomike"*

## 3.2 Situata socio-ekonomike

### 3.2.1 Veçoritë fizike dhe mjedisore

Bashkia e Belshit shtrihet pothuajse tërësisht në pllajën kodrinore karstike të Dumresë, një zonë kodrash të buta me bazë gëlqerore mbi të cilat është krijuar një panoramë piktoreske me 85 liqene karstike me një sipërfaqe të përgjithshme prej 14.2 km². Kodrat e Dumresë kanë qenë në përgjithësi të mbuluara me pyje dushku. Belshi është një bashki tërësisht rurale me produkte të diversifikuara nga blegtoria te zarzavatet dhe bostanoret, por një numër fermerësh janë përqendruar te kultivimi i duhanit, rigonit, ullirit për të cilin janë specializuar. Gjithashtu në këtë zonë ka burime të mermerit të kuq dhe gipsit.

### 3.2.2 Të dhëna demografike

Bashkia Belsh përbëhet nga pesë njësi administrative: Belsh, Kajan, Rrasë, Grekan dhe Fierzë. Bashkia e Belshit kufizohet në veri me bashkinë Peqin, në lindje me bashkinë Cërrik, në jug me bashkinë Kuçovë dhe në perëndim me bashkinë Lushnje. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Belshit. Sipas Censusit të vitit 2011, kjo bashki numëron 19.503 banorë, ndërkohë që sipas Regjistrit Civil kjo bashki ka një popullsi prej 33.632 banorë dhe densitet prej 168.88 banorë për km². Sipërfaqja e bashkisë së re është 196.44 km². Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 34 fshatra. Në këndvështrimin e shpërndarjes së popullsisë në territor: 45% e popullsisë jeton në njësinë administrative Belsh, 20% e popullsisë jeton në njësinë administrative Kajan, ndërsa 35% e popullsisë jeton në tre njësitë e tjera. Tabela 1 paraqet numrin e popullsisë dhe familjeve sipas njësive administrative.

Tabela 1: Shpërndarja e popullsisë sipas njësive administrative

| Njësia Administrative | Numri Popullsisë | Numri Familjeve |
|---|---|---|
| BELSH | 15341 | 4638 |
| GREKAN | 5133 | 1662 |
| KAJAN | 6753 | 2082 |
| RRASE | 2412 | 789 |
| FIERZË | 3993 | 1232 |
| **TOTALI** | **33632** | **10403** |

*Burimi: Regjistri i Gjendjes Civile (Qershor 2023)*

Ekziston një diferencë e thellë ndërmjet të dhënave mbi popullsinë sipas regjistrit të zyrës së gjendjes civile dhe sipas Censusit. Arsyeja qëndron në faktin se ndërsa Censusi evidenton

popullsinë faktike banuese, regjistri i gjendjes civile popullsinë e regjistruar, e cila për shkak të lëvizjeve migratore nuk përputhet me popullsinë banuese.

### 3.2.3 Arsimi

**Shërbime të kujdesit parashkollor dhe shkollor.** Shërbimet e kujdesit parashkollor sigurohen nëpërmjet trajtimit ditor të fëmijëve në çerdhe dhe kopshte. Janë gjithsej 20 kopshte me 22 grupe fëmijësh në territorin e Bashkisë. Numri më i madh i kopshteve është në Grekan dhe Kajan, përkatësisht 31.3% e kopshteve dhe 33.8% e grupeve. Numri më i vogël i kopshteve është në Rrasë, 1 kopësht me 1 grup fëmijësh, domethënë 6.3% e kopshteve dhe 1.4% e grupeve.

Tabela 2: Të dhëna për arsimin parashkollor sipas njësive administrative

| Njësia Administrative | Nr kopshtesh | Kapaciteti | Nr. fëmijësh | Nr. Edukatoresh |
|---|---|---|---|---|
| BELSH | 9 | 11 grupe | 182 | 14 |
| KAJAN | 4 | 4 grupe | 41 | 4 |
| GREKAN | 3 | 3 grupe | 39 | 3 |
| FIERZE | 3 | 3 grupe | 37 | 3 |
| RRASE | 1 | 1 grup | 7 | 1 |
| TOTAL | **20** | **22 grupe** | **306** | **25** |

*Burimi: Drejtoria Arsim. Kulturë dhe Mbrojtje Sociale (2023)*

Tabela 2 paraqet të dhëna mbi numrin e fëmijëve në kopshte si edhe të edukatoreve. Janë gjithsej 306 fëmijë, të cilët ndjekin arsimin parashkollor në bashkinë Belsh. Ky numër është shumë më i vogël se sa nevoja për këtë shërbim, nëse konsiderojmë edhe faktin që arsimi parashkollor është përfshirë në skemën e arsimit të detyrueshëm. Vlerësimet e realizuara në të kaluarën kanë nxjerrë në pah se shkalla e frekuentimit të kopshteve është shumë e ulët, ndërmjet 15 dhe 20%.

Në Bashki ndodhen 11 shkolla, të cilat u shërbejnë 1357 nxënësve. Ka 165 mësues dhe 4 psikologë në të gjithë bashkinë. Niveli i braktisjes së shkollës raportohet të jetë 0. Të dhënat prezantohen në tabelën 3.

Tabela 3: Shërbimi pikologjik dhe niveli i braktisjes së shkollës në shkollat 9-vjeçare

| Njësia administrative | Nr. Shkollash | Nr. nxënësish | Niveli i Braktisjes së shkollës (nr. nxënësish) | Nr. mësuesish | Nr. psikologësh (të punësuar pranë shkollave të NJA) |
|---|---|---|---|---|---|
| BELSH | 6 | 682 | 0 | 79 | 2 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| KAJAN | 2 | 218 | 0 | 24 | 0 |
| GREKAN | 1 | 210 | 0 | 29 | 0 |
| FIERZE | 1 | 144 | 0 | 21 | 1 |
| RRASE | 1 | 103 | 0 | 12 | 1 |
| **TOTAL** | **11** | **1357** | **0** | **165** | **4** |

*Burimi: Drejtoria Arsim, Kulturë dhe Mbrojtje Sociale, Bashkia Belsh (2023)*

### 3.2.4 Ekonomia

Burimet kryesore të të ardhurave në Bashkinë Belsh janë turizmi, bujqësia, blegtoria, emigrimi, dhe bizneset private. Banorët e Belshit merren kryesisht me kultivimin e rigonit, ullirit, rrushit dhe duhanit. Një pjesë e popullsisë të ardhurat i siguron nga emigracioni. Vitet e fundit në Belsh është zhvilluar dhe turizmi, ku janë krijuar restorante, bujtina, hotele, dumrea eco park, ku është bërë i mundur punësimi i disa të rinjve. Këto zhvillime kanë efekt pozitiv në ekonominë lokale.

### 3.2.5 Punësimi dhe papunësia

Bashkia Belsh ka një përqindje të lartë të papunësisë. Sipas të dhënave të INSTAT, niveli i papunësisë është 16.6%. Niveli më i lartë i papunësisë raportohet në Belsh qendër (njësia administrative e Belshit) me 24.4% dhe në njësinë administrative Rrasë me 25.2%. Kjo gjë është e lidhur dhe me faktin se pjesa më e madhe e popullsisë është e punësuar në bujqësi, ndërkohë që sektorët e tjerë janë shumë të dobët nga pikëpamja ekonomike.

Papunësia tek të rinjtë është mjaft problematike me 33.3%. Dëshira e ulët e të rinjve për tu përfshirë në sektorin bujqësor sjell dhe një përqindje kaq të lartë të papunësisë për këtë grup shoqëror. Gjithashtu, problematike është dhe papunësia tek gjinia femërore me 17%. Sërish, ky rezultat lidhet me varësinë e madhe nga bujqësia dhe me mungesën e mundësive për punësim në sektorët e tjerë ekonomik. Gjithsesi vihet re që kryesisht në zonat më të mëdha bujqësore është popullsia e gjinisë femërore ajo që meret më së shumti me punimin e tokës dhe grumbullimin e produkteve. Kjo lë hapësirë për të menduar për forma të ndryshme të punësimit më të madh të kësaj gjinie në këtë sektor të ekonomisë, duke e diversifikuar më tej atë dhe duke shtuar ciklet e këtij sektori, me procese si përpunimi dhe tregëtimi, të cilët mund të përbëjnë një burim efektiv të zhvillimit të ekonomisë dhe tregut të punës.

Për të analizuar situatën në lidhje me nivelin e papunësisë dhe karakteristikat e punëkërkuesve të papunë në Bashkinë Belsh u përdorën të dhëna nga Zyra e Punës. Nga 126 persona të papunë—të regjistruar në Zyrën e Punës në vitin 2022—82 ishin gra dhe 44 ishin burra. Numri i personave me aftësi të kufizuara të regjistruar në Zyrën e Punës ishte shumë i ulët, 2. Ndërkohë, ishin regjistruar 13 Romë dhe Egjiptianë, 4 emigrantë të kthyer, dhe 24 gra kryefamiljare. Rreth 80% e të papunëve të regjistruar në Zyrën e Punës jetonin në qytet.

Tabela 4: Papunësia sipas grupeve

| Grupmosha | Urban | Rural | Sipas gjinisë | | Sipas statusit | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Femra | Meshkuj | PAK | Romë/ Egjiptiane | Emigrate te kthyer | Gra kryefamijare |
| 16-19 vjec | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 20-24 vjec | 9 | 1 | 5 | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 25-29 vjec | 5 | 4 | 4 | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 30-39 vjec | 18 | 4 | 12 | 10 | 2 | 3 | 1 | 10 |
| 40+ | 68 | 16 | 61 | 23 | 0 | 10 | 3 | 14 |
| TOTAL | **100** | **26** | **82** | **44** | **2** | **13** | **4** | **24** |

*Burimi: Zyra e Punës (2022)*

Pjesa më e madhe e të papunëve të regjistruar në Zyrën e Punës kishin arsim 9-vjeçar, të ndjekur nga arsimi i mesëm i përgjithshëm. Tabela 5 paraqet të dhëna për nivelin e papunësisë sipas nivelit arsimor.

Tabela 5: Papunësia sipas nivelit arsimor

| Niveli arsimor | Femra | Meshkuj | TOTALI |
|---|---|---|---|
| Pa arsim | 2 | 0 | 2 |
| Fillore | 4 | 5 | 9 |
| 9 vjeçare | 56 | 31 | 87 |
| E mesme pergjithshme | 14 | 7 | 21 |
| E mesme profesionale | 2 | 1 | 3 |
| Arsimi universitar | 4 | 0 | 4 |
| TOTAL | **82** | **44** | **126** |

*Burimi: Zyra e Punës (2022)*

Numri i të papunësve sipas njësive administrative paraqitet në tabelën 6. Po ashtu prezantohet raporti pjesëmarrës në skemën e ndihmës ekonomike kundrejt të qenurit punëkërkues për njësi. Raporti, ashtu siç demonstron kolona e fundit e tabelës 6 varion nga njësia në njësi.

Tabela 6: Papunësia sipas njësive administrative

| NJËSIA ADMINISTRATIVE | FEMRA | MESHKUJ | TOTALI | NGA FAMILJE ME N.E | PËRQINDJA E INDIVIDËVE N.E/ PUNËKERKUES PËR NJËSI |
|---|---|---|---|---|---|
| BELSH | 65 | 35 | 100 | 68 | 68% |
| GREKAN | 5 | 2 | 7 | 5 | 71% |
| KAJAN | 5 | 2 | 7 | 7 | 100% |
| FIERZE | 3 | 2 | 5 | 4 | 80% |
| RRASE | 4 | 3 | 7 | 3 | 43% |
| **TOTAL** | **82** | **44** | **126** | 87 | **69%** |

*Burimi: Zyra e Punës (2022)*

### 3.2.6 Shëndetësia

Aktualisht, janë 2000 persona që marrin mjekim për sëmundje kronike. Shërbimi shëndetësor ofrohet në një hapësirë goxha të madhe, ku hasen edhe probleme të lidhura me infrastrukturën fizike, përveç të tjerave. Duhet të ketë bashkërendim të burimeve njerëzore—ekipe multidisiplinare (mjekë, infermierë, punonjës socialë, psikologë), pushtet lokal, njësi administrative, kryetarë të fshatrave në evidentimin e rasteve dhe menaxhimin e problematikave që lidhen drejtpërsëdrejtë me cilësinë e shëndetit të popullatës në përgjithësi dhe personave me sëmundshmëri kronike në veçanti. Ka një shtim të thirrjeve për të dhënë shërbim urgjence në banesë apo kudo ndodh një urgjencë e caktuar. Kjo kërkon bashkërendim institucional midis qendrave shëndetësore, pushtetit lokal, strukturave të urgjencës kombëtare, shërbimit social, etj. Prioritet i është dhënë qasjes në shërbime të sëmurëve kronikë. Ka një rritje të sëmundshmërisë që lidhet me cilësinë e jetesës (si ushqyrjen, aktivitetin fizik, izolimin social). Qeveria shqiptare ka lançuar projektin Kujdesi Shëndetësor në Banesë, i cili duket të jetë një nga prioritetet e të ardhmes. Duke qenë se bëhen kërkesa të vazhdueshme nga mosha e tretë, një qendër që i shërben kësaj moshe duket të jetë e domosdoshme në territorin e bashkisë Belsh. Duke qenë se mosha mesatare e popullsisë është rritur—dhe parashikohet të rritet edhe më shumë në vazhdim, për shkak edhe të largimit të popullsisë të re në moshë—duhet të shtohen shërbimet që mbështesin moshën e tretë.

## 3.3 Nevojat për shërbime sociale të grupeve vulnerabël dhe atyre në risk

### 3.3.1 Familjet e varfra

Ndihma Ekonomike është transfertë monetare për familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme. Skema e Ndihmës Ekonomike (NE) është instrumenti kryesor për zbutjen e

varfërisë në vend dhe ky program, që synon të sigurojë mbrojtje sociale për familjet në nevojë që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme, financohet nga buxheti kombëtar. Të dhënat e mundësuara nga Regjistri Elektronik përmes Sektorit të Mirëqenies Sociale dhe Përkujdesit Shoqëror në Bashkinë Belsh, na japin këtë situatë të familjeve pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme, përfituese të ndihmës ekonomike:

Tabela 7: Familjet përfituese të ndihmës ekonomike

| NJESIA ADMINISTRATIVE | Familje gjendje civile | Familje me NE | Familje perfituese nga fondi 6% |
|---|---|---|---|
| BELSH | 4638 | 181 | 16 |
| GREKAN | 1662 | 143 | 5 |
| KAJAN | 2082 | 162 | 1 |
| RRASE | 789 | 93 | 0 |
| FIERZË | 1232 | 94 | 1 |
| **TOTALI** | **10403** | **673** | **23** |

*Burimi: Zyra e Ndihmës Ekonomike (Qershor 2023)*

Në qershor të vitit 2023, numri i familjeve pjesë e skemës së ndihmës ekonomike ishte 673 (ose 6.5% e familjeve), ndërsa numri i familjeve që përfitonin nga fondi 6% (ose 0.22%) ishte 23.

Tabela 8 paraqet karakteristikat e familjeve që përfitojnë nga programi i ndihmës ekonomike. Numri i grave dhe burrave që përfitojnë nga programi i ndihmës ekonomike është 1310 dhe 1301, përkatësisht. Numri i fëmijëvë është 957, numri i individëve në moshë pune është 1574, numri i idividëve në moshë pensioni është 70, dhe numri i kryefamiljareve është 74.

Tabela 8: Individë në familjet përfituese të ndihmës ekonomike sipas grupmoshave dhe gjinisë

| NJESIA ADMINISTRATIVE | Sipas gjinisë F | Sipas gjinisë M | Fëmijë (0-18 vjeç) | Në moshë pune (19-64 vjeç) | Moshë pensioni Mbi 64 vjeç | Kryefamiljare grua |
|---|---|---|---|---|---|---|
| BELSH | 347 | 339 | 272 | 398 | 16 | 25 |
| GREKAN | 273 | 283 | 206 | 332 | 18 | 16 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| KAJAN | 330 | 323 | 227 | 408 | 18 | 19 |
| RRASE | 186 | 179 | 133 | 227 | 5 | 5 |
| FIERZË | 174 | 177 | 119 | 209 | 13 | 9 |
| TOTALI | 1310 | 1301 | 957 | 1574 | 70 | 74 |

*Burimi: Zyra e Ndihmës Ekonomike (Qershor 2023)*

### 3.3.2 Personat me aftësi të kufizuar

Referuar të dhënave të Zyrës për Gjendjen Civile, 3.3% e popullsisë në Bashkinë Belsh përfiton nga programi i pagesave monetare të aftësisë së kufizuar, të financuar nga buxheti kombëtar. Tabela më poshtë paraqet numrin e personave me aftësi të kufizuara sipas njësive administrative. Administratorët shoqërorë kanë raportuar se janë 678 invalidë pune, 171 të verbër, 25 para-tetra plegjikë, dhe 690 persona me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore (në total 1564 persona).

Tabela 9: Të dhëna për personat me aftësi të kufizuara sipas njësive administrative

*Burimi. Administratorët shoqërorë (2023)*

| Njësia Administrative | INVALID PUNE | TË VERBËR | | PARA-TETRA PLEGJIK | | PAK FIZIK & MENDOR | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Gjithsej | Me kujdestar | Gjithsej | Me kujdestar | Gjithsej | Me kujdestar |
| BELSH | 327 | 66 | 15 | 7 | 7 | 288 | 44 |
| GREKAN | 100 | 29 | 1 | 7 | 7 | 107 | 13 |
| KAJAN | 114 | 27 | 6 | 3 | 3 | 151 | 24 |
| RRASE | 40 | 20 | 2 | 3 | 3 | 57 | 8 |
| FIERZË | 97 | 29 | 9 | 5 | 5 | 87 | 9 |
| TOTAL | **678** | **171** | **33** | **25** | **25** | **690** | **98** |

Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha njësitë administrative vlerësohet të jetë 44. Shpërndarja sipas grupmoshave paraqitet në tabelën 10.

Tabela 10: Të dhëna për fëmijët me aftësi të kufizuara sipas njësive administrative

| NJËSIA | |
|---|---|

| ADMINISTRATIVE | SIPAS GRUP-MOSHAVE | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | 0-6 vjeç | 6-15vjeç | 15-18 |
| BELSH | 22 | 4 | 14 | 4 |
| GREKAN | 5 | 1 | 3 | 1 |
| KAJAN | 11 | 0 | 6 | 5 |
| RRASE | 2 | 0 | 2 | 0 |
| FIERZË | 4 | 0 | 4 | 0 |
| TOTAL | 44 | 5 | 29 | 10 |

*Burimi: Administratorët shoqërorë (2023)*

Aftësia e kufizuar është një faktorët më kritikë të përjashtimit shoqëror. Në Bashkinë Belsh, personat me aftësi të kufizuar përjetojnë përjashtim të shumfishtë sepse përveç aftësisë së kufizuar, janë të përjashtuar nga tregu i punës si edhe nga mundësia për të siguruar një nivel të pranueshëm jetese. Individët me aftësi të kufizuar përfitojnë pagesë paaftësie si edhe kujdestarie (në rastet që ajo aplikohet), por që të ri-integrohen në jetën ekonomike dhe sociale, ata kanë nevojë për shërbime ri-aftësimi dhe integrimi. Mbrojtja, ri-integrimi dhe përfshirja e individëve me aftësi të kufizuar duhet të jenë pjesë thelbësore e politikave sociale të qeverisë vendore.

### 3.3.3 Mbrojtja dhe përkujdesja për fëmijët

Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes së veçantë, të njohur dhe sanksionuar në Konventën për të drejtat e Fëmijëve, të ratifikuar nga Qeveria Shqiptare. Janë dy ligje që të ndërthurura me njëra tjetrën që janë marrë për bazë në analizën për mbrojtjen dhe përkujdesjen për fëmijët: Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Në këndvështrimin e garantimit të mbrojtjes që duhet t'i mundësohet çdo fëmije, ky ligj përcakton mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, bashkë me detyrat specifike që garantojnë ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave me efektivitet, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës. Në kreun III “Mekanizmat institucionalë për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, neni 34 përcakton si mekanizëm këshillimor dhe koordinues institucional në nivelin vendor grupin teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative. Ndërkohë strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor janë: bashkia; struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki; njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki; njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësive administrative; dhe punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

Tabela më poshtë paraqet numrin e fëmijëve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Sipas Njësisë të Mbrojtjes së Fëmijëve, vlerësohet të ketë 4 fëmijë të dhunuar, 5 jetimë, dhe 45 fëmijë me aftësi të kufizuara.

Tabela 11: Fëmijë në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror

| Njësia Administrative | Fëmijë të dhunuar/ shfrytëzuar (dhuna/trafikimi) | Jetimë | Fëmijë me AK 0-18 vjeç |
|---|---|---|---|
| BELSH | 1 | 3 | 29 |
| GREKAN | 0 | 0 | 6 |
| KAJAN | 2 | 1 | 4 |
| RRASE | 0 | 1 | 2 |
| FIERZË | 1 | 0 | 4 |
| TOTAL | 4 | 5 | 45 |

*Burimi: Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve Bashki (2022)*

Në Bashkinë Belsh është krijuar dhe funksionon Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve; megjithatë, aktiviteti i kësaj njësie nuk është i lehtë. Ai përballet me sfidën më kritike: mungesën e shërbimeve për fëmijë në territorin e bashkisë. Njësia i referon rastet kritike në Bashkinë Elbasan apo bashkëpunon me organizata të shoqërisë civile. Sidoqoftë, nevoja për të garantuar përfshirjen e fëmijëve në komunitetin e tyre kërkon që disa shërbime të funksionojnë edhe në territorin e Bashkisë Belsh.

### 3.3.4 Dhuna në familje

Në përputhje me ligjin 47/2018, që ka sjellë ndryshime të Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdheniet familjare" njësitë e qeverisjes vendore kanë këto detyra: (i) angazhimin në krijimin e strukturave të shërbimit social për rastet e dhunës në familje; (ii) instalimin e një linje telefonike rajonale 24-orëshe, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore dhe OJF-të, duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin mes tyre; (iii) ngritjen e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit, si dhe koordinimin e punës me ato ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse. (iv) Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, zyra e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore monitoron respektimin e urdhrit të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit. Ndërkohë Bashkia ka detyrimin për ngritjen dhe funksionimin e: (i) Komiteteve Drejtuese lokale që drejtohen nga Kryetari i Bashkisë dhe janë komitete koordinuese ad hoc; (ii) Ekipi teknik ndërdisiplinor që ngrihet me vendim të komitetit drejtues më qëllim bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse në nivel vendor në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje; (iii) Pranë çdo bashkie caktohet koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, i cili është përfaqësuesi i zyrës së shërbimeve sociale pranë asaj njësie të qeverisjes vendore.

Në vitin 2022 janë regjistruar 12 raste të dhunës në familje, nga të cilat 4 kanë marrë Urdhër Mbrojtjeje.

Tabela 12: Të dhëna mbi viktimat e dhunës në familje

| Karakteristika | Të dhëna të Policisë | Të dhëna të Bashkisë | Të dhëna të shëndetësisë |
|---|---|---|---|
| Urdhër i menjëhershëm mbrojtje | 0 | 0 | 0 |
| Urdhër mbrojtje | 4 | 4 | 0 |
| Numri i rasteve me dëmtime/plagosje | 0 | 0 | 0 |
| Numri i rasteve që viktima ka humbur jetën nga dhuna | 0 | 0 | 0 |
| Numri total i viktimave të dhunës gra | 12 | 12 | 0 |
| Numri i viktimave total i viktimave të dhunës burra | 0 | 0 | 0 |

*Burimi: Koordinatori për Masat kundër Dhunës në Familje, Policia, Strukturat e shëndetësisë (2022)*

Tabela më poshtë paraqet numrin e viktimave të dhunës në familje sipas njësive administrative. Rastet janë raportuar në njësitë administrative Kajan dhe Belsh.

Tabela 13: Të dhëna mbi viktimat e dhunës në familje sipas njësive administrative

| Njësia administrative | Numri i rasteve të dhunës | Të dhëna të Policisë | Të dhëna të Bashkisë | Të dhëna të shëndetësisë |
|---|---|---|---|---|
| BELSH | 9 | 9 | 9 | 0 |
| GREKAN | 0 | 0 | 0 | 0 |
| KAJAN | 3 | 3 | 3 | 0 |
| RRASE | 0 | 0 | 0 | 0 |
| FIERZË | 0 | 0 | 0 | 0 |
| TOTAL | 12 | 12 | 12 | 0 |

*Burimi: Koordinatori për Masat kundër Dhunës në Familje, Policia, Strukturat e shëndetësisë (2022)*

Duke nisur nga viti 2018, pjesë e bashkisë Belsh është Koordinatori i Dhunës për Menaxhimin e Rasteve të Dhunës në Familje. Në Bashkinë Belsh—në bashkëpunim me FGE—u ngrit për herë të parë mekanizmi i referimit të dhunës në familje. Gjithashtu, nga FGE u bë dhe trajnimi i të

gjithë aktorëve për menaxhimin e rasteve të dhunës. Nga ngritja e mekanizmit, filloi bashkëpunimi për rastet dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve. Sfida më e madhe është mungesa e shërbimeve të specializuara. Rastet referohen gjithmonë tek OJF-të.

### 3.3.5 Strehimi

Numri i familjeve që aplikuan për strehim social në vitin 2022 ishte 43, nga të cilat 3 ishin familje me kryefamiljare grua, 33 familje që ishin pjesë e skemës së ndihmës ekonomike, dhe 1 i moshuar i vetmuar. Të dhënat—sipas njësive administrative—jepen në tabelën 14.

Tabela 14: Të dhëna mbi familjet e pastreha

| Njësia administrative | Numri i familjeve që kanë aplikuar për strehim social | Numri i familjeve me grua kryefamiljare | Numri i individëve në familjet aplikuese për strehim social | Numri i të moshuarve të vetmuar aplikues për strehim social | Numri i viktimave të dhunës në familje që kanë aplikuar strehim social | Numri i familjeve aplikuese për strehim social që përfitojnë ndihmën ekonomike |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Belsh | 25 | 2 | 0 | 0 | 0 | 20 |
| Grekan | 9 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 |
| Kajan | 5 | 1 | 0 | 1 | 0 | 4 |
| Rrase | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| Fierzë | 2 | 1 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| TOTAL | 43 | 3 | 0 | 1 | 0 | 33 |

*Burimi: Zyra e Strehimit (2022)*

Bashkia belsh ka në zbatim programe strehimi, ku aktualisht trajton rreth 56 familje me bonus qeraje. Përpara vitit 2023, është realizuar programi i riparimit të shtëpive të familjeve në nevojë.

### 3.3.6 Të moshuarit e vetmuar

Braktisja e të moshuarve është një problem në rritje. Sektori i Mirëqenies Sociale dhe Përkujdesit Shoqëror në Bashkinë Belsh ka bërë disa vlerësime, të cilat hedhin dritë mbi numrin e të moshuarve që kanë nevojë për shërbime. Konkretisht, janë 160 të moshuar që kanë kërkuar shërbime në familje, 125 të moshuar që kanë kërkuar shërbime në qendër ditore përkujdesi, dhe 25 të moshuar që kanë kërkuar shërbime në qendër rezidenciale. Të dhënat jepen të ndara sipas njësive administrative në tabelën 15.

Tabela 15: Të dhëna mbi të moshuarit në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror

| Njësia administrative | Numri i të moshuarve që kanë kërkuar shërbime në familje | Numri i të moshuarve që kanë kërkuar shërbime në qendër ditore përkujdesi | Numri i të moshuarve që kanë kërkuar shërbime në qendër rezidenciale | Numri i të moshuarve që jetojnë vetëm dhe përfitojnë ndihmë ekonomike |
|---|---|---|---|---|
| Belsh | 70 | 30 | 20 | 1 |
| Grekan | 0 | 0 | 0 | 1 |
| Kajan | 60 | 70 | 0 | 0 |
| Rrase | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Fierzë | 30 | 25 | 5 | 1 |
| **TOTAL** | **160** | **125** | **25** | **3** |

*Burimi: Sektori i Mirëqenies Sociale dhe Përkujdesit Shoqëror (2023); të dhëna të mbështetura tek vëzhgimet në terren.*

### 3.3.7 Divorcet

Personat e divorcuar përbëjnë një nga grupet e parashikuara në ligjin 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Megjithatë, të dhënat rreth divorceve në bashkinë Belsh mungojnë.

### 3.3.8 Varësia nga alkooli

Numri i përdoruesve të alkoolit vlerësohet të jetë midis 12 dhe 19, ashtu siç prezantohet në tabelën 16.

Tabela 16: Të dhëna mbi përdoruesit e alkoolit sipas njësive administrative

| Njësia administrative | Numri i përdoruesve | Të dhëna të Policisë | Të dhëna të Bashkisë | Të dhëna të shëndetësisë |
|---|---|---|---|---|
| BELSH | 3 | 5 | 3 | 0 |
| GREKAN | 0 | 3 | 5 | 0 |
| KAJAN | 5 | 2 | 5 | 0 |
| RRASE | 2 | 1 | 2 | 0 |
| FIERZË | 4 | 1 | 4 | 0 |
| TOTAL | 14 | 12 | 19 | 0 |

*Burimi: Polici, Bashki, Shëndetësi (2022)*

### 3.3.9 Emigrantët e kthyer

Emigrantët e kthyer përbëjnë një tjetër grup të parashikuar në ligjin 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Numri i emigrantëve të kthyer vlerësohet të jetë 476—një numër relativisht i lartë—nga të cilët 183 janë fëmijë, 190 të rritur, 39 të rinj, dhe 64 i përkasin kategorive të ndryshme. Të dhënat paraqiten në tabelën 17.

Tabela 17: Numri i emigrantëve të kthyer

| Të rikthyerit | Fëmijë | Të rritur | Të rinj | Kategori ndryshme | Total |
|---|---|---|---|---|---|
| Bashkia Belsh | 183 | 190 | 39 | 64 | 476 |

*Burimi: Diagonia Agapes (2022-2023)*

Vështirësia ekonomike, e lidhur kryesisht me papunësinë, është një ndër problemet kryesore që përmendet nga të rikthyerit si shkaku kryesor i largimit të tyre nga Shqipëria. Për zonën e Belshit, Gjermania dhe Italia janë vendet në të cilat emigrantët kanë emigruar. Arsyeja kryesore e rikthimit në Shqipëri lidhet me detyrimin apo dëbimin nga vendi i huaj për gjysmën e të të rikthyerve pjesmarrës në studim. Faktor të tjerë ndikues kanë qenë familjar apo të afërm të tyre që u kanë kërkuar që të rikthehen si edhe pamundësia për të gjetur një punë në vendin ku kanë emigruar. Arsyet që i shtyjnë të rikthyerit për të emigruar sërisht lidhen me vështirësitë ekonomike, mungesën e punësimit, strehimit dhe dëshirën për një jetë më të mirë. Pas rikthimit në Shqipëri, shumica e të rikthyerve kanë raportuar se nuk janë kontaktuar nga institucionet publike dhe jopublike për t'u ofruar mbështetje. Ndërsa për pjesën tjetër, institucioni me të cilat të rikthyerit kanë pasur më shumë ndërveprim pas rikthimit është Zyra e Ndihmës Ekonomike. Ajo që vihet re dukshëm është se shumica e të rikthyerve nuk janë në dijeni mbi shërbimet mbështetëse që ofrohen për të rikthyerit në zonën e Belshit. Lidhur me shërbimet që të rikthyerit kanë përfituar nga institucionet publike dhe jopublike pas rikthimit në Shqipëri, gjysma e të anketuarve kanë raportuar se kanë marrë shërbime të punësimit, të arsimimit të fëmijëve dhe të mbështetjes financiare.

Profesionistët në zonën e Belshit nuk kanë një kuptim të qartë mbi termin shërbime psikosociale. Në zonën e Belshit janë bërë studime të ngjashme që kanë patur në fokus vlerësimin e nevojave që kanë të kthyerit nga emigracioni, por asnjë prej tyre nuk është fokusuar specifikisht vetëm tek nevojat psikosociale. Asistenca për të ndihmuar fëmijët që të rikthehen në shkollë dhe të mos ndihen të veçuar nga bashkëmoshatarët e tyre është një nga nevojat psikosociale që është identifikuar edhe nga profesionistët e fushës. Bashkia në zonën e Belshit ofron vetëm ndihmën ekonomikedhe përpiqen të bashkëpunojnë me institucionet jopublike të cilat luajnë një rol parësor në ofrimin e shërbimeve dhe riintegrimin e familjeve të rikthyera nga emigracioni. Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat profesionale të stafit që ofron shërbime për të rikthyerit vlerësohen si shumë të mira nga vetë profesionistët.

## 3.4 Vlerësimi i Shërbimeve Aktuale

### 3.4.1 Shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë

#### 3.4.1.1. Shërbime mbështetëse apo fuqizuese për familjet përfituese të ndihmës ekonomike

*Kategori prioritare për shërbime të kujdesit shoqëror:*

- Individët me aftësi të kufizuar, përfshirë fëmijët;
- Familjet e varfëra;
- Fëmijë në nevojë për mbrojtje;
- Gra të vetme, mbajtëse të familjes;
- Gra të dhunuara;
- Të moshuar të vetmuar.

Bashkia nuk ka aktualisht programe specifike për fuqizimin ekonomik të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Çdo individ madhor i këtyre familjeve drejtohet tek Zyra e Punës në Elbasan, në varësi të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

#### 3.4.1.2. Shërbime për punëkërkuesit e papunë

Me përjashtim të pagesës së papunësisë, e cila mbulohet nga Zyra e Punës e Elbasanit, në Bashkinë Belsh nuk ofrohet asnjë shërbim tjetër.

#### 3.4.1.3. Shërbime për personat me aftësi të kufizuara

*Kategori prioritare për shërbime të kujdesit shoqëror:*

- Personat me probleme të shëndetit mendor
- Paraplegjikët
- Të verbërit
- Invalidët e punës

Në Bashkinë Belsh është ngritur një qendër multifunksionale ditore për personat në nevojë, ku marrin shërbim dhe personat me aftësi të kufizuar. Shërbimet konsistojnë në kafe, ushqim, dhe fizioterapi. Në qendër —në bashkëpunim me një projekt me UNDP dhe MEDPAK—është shtuar dhe një logoped me kohë të plotë dhe një psikolog me kohë të pjesshme, të cilët do t'i ofrojnë shërbim grupmoshave 0-18 vjeç dhe 18-35 vjeç.

#### 3.4.1.4. Sistemi komunitar i mbrojtjes dhe përkujdesit për fëmijë

*Kategori prioritare për shërbime të kujdesit shoqëror:*

- Fëmijë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike

- Fëmijë me aftësi të kufizuara
- Fëmijë në nevojë për mbrojtje

Çdo rast i fëmijëve në nevojë për mbrojtje menaxhohet nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve.Mungesa e shërbimeve e çdo lloj shërbimi kujdesi shoqëror për fëmijët në territorin e Bashkisë Belsh mbetet sfidë.Rastet referohen të OJF që ofrojnë shërbime për këtë kategori.Qeshor2023 në bashkëpunim me UNDP dhe MEDPAK kemi fitur një projekt për personat me aftesi të kufizuar ku janë punësuar një logoped me kohët të plotë dhe një psikolog me kohë të pjesëshme ku do ofrojnë shërbim dhe për fëmijet me aftësi të kufizuar

Shërbimi i kujdesit alternativ për fëmijë pa kujdes prindëror gjithashtu nuk është i ngritur, por rastet emergjente apo zgjidhjet me afatgjata janë menaxhuar me mbështetjen e personave me lidhje gjaku me fëmijën. Tre fëmijë pa kujdes prindëror janë të vendosur aktualisht në familje kujdestare, por mungesa e burimeve njerëzore e bën të pamundur monitorimin nga ana e Bashkisë të jetesës së tyre në familjet kujdestare.

3.4.1.5. Shërbime për viktimat e dhunës në familje

*Kategori prioritare për shërbime të kujdesit shoqëror:*

- Viktima të dhunës në familje
- Gratë dhe fëmijët

Rastet e dhunës menaxhohen nga Koordinatorja, e cila punon me viktimat e dhunës. Rastet referohen për shërbim psikologjik dhe juridik tek Forumi i Gruas Elbasan pasi vetë bashkia nuk ofron shërbime të kujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje.

3.4.1.6. Shërbimi i strehimit social

*Kategori prioritare për shërbime të kujdesit shoqëror:*

Familje/individ që janë të pastrehë dhe që i përkasin një prej grupeve të mëposhtme:

- Familje përfituese të ndihmës ekonomike
- Persona me aftësi të kufizuara/invalid pune
- Viktima dhune në familje
- Të kthyer nga emigracioni dhe në vështirësi ekonomike

Aktualisht, në Bashkinë Belsh trajtohen me bonus qeraje 44 familje.

3.4.1.7. Shërbime për të moshuarit

*Kategori prioritare për shërbime të kujdesit shoqëror:*

- Të moshuar pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike
- Të moshuar që jetojnë vetëm/të braktisur

Edhe pse vihet re një tendencë rritëse e të moshuarve që kanë nevojë për shërbime mbështetëse, këto shërbime janë tërësisht të munguara në këtë Bashki. Mungojnë shërbimet në familje apo qendra ditore.

### 3.4.2 Shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Qarkut Elbasan

Në përputhje me bazën e të dhënave të Shërbimit Social Shtetëror në Qarkun Elbasan, nga 7 bashkitë e qarkut, vetëm 4 ofrojnë shërbime shoqërore. Shërbimet për individët në nevojë përbëjnë 36% të të gjithë shërbimeve të qarkut. 80% e shërbimeve për individët në nevojë ofrohen në Bashkinë Elbasan. Sidoqoftë, është tepër e vështirë për grupet në nevojë në Bashkinë Belsh që të përfitojnë shërbime në Bashkinë Elbasan.

# 4. Vlerësimi i kapaciteteve institucionale, njerëzore, dhe financiare për të ofruar shërbime sociale

## 4.1 Organizimi i strukturave të shërbimeve të kujdesit shoqëror

Në përputhje me Rregulloren e Bashkisë Belsh, struktura përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes sociale dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror është Sektori i Mirëqenies Sociale dhe Përkujdesit Shoqëror. Nenet 52-57 të Rregullores specifikojnë detyrat, pozicionet e punës në Sektorin brenda Bashkisë dhe në njësitë administrative. Nga analiza e detyrave funksionale rezulton se:

Përgjegjësi i sektorit, në përputhje me nenin 52 të Rregullores, përmbush detyra që lidhen si me administrimin e programit të pagesave të mbrojtjes sociale (Ndihma ekonomike dhe PAK), ashtu dhe me shërbimet e kujdesit shoqëror. Në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror përmbush këto detyra: (i) Të rregullojë marrëdhëniet e financimit e të ofrimit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore; (ii) Përgatit të dhëna për familjet në nevojë; (iii) Te indentifikoj femijet qe u shkelen te drejtat e tyre rast pas rasti. Përcakton nismën për pranimin e fëmijëve në institucionet rezidenciale publike dhe private të përkujdesit shoqëror; (iv) Të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet; (v) Të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre; (vi) Të bashkëpunojë me OJF-të;

Administratori shoqëror, sipas nenit 53 të Rregullores, ka detyra që lidhen si me programin e mbrojtjes sociale, ashtu dhe në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror. Në këndvështrimin e kësaj të fundit detyrat kryesore të parashikuara në Rregullore janë: (i) Të evidentojë grupet në nevojë brenda territorit të bashkisë dhe të krijojë, brenda kuadrit ligjor, kushtet e favorshme për t'iu ofruar ndihmën e nevojshme ekonomike dhe shërbimin e duhur social familjeve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuar; (ii) Të hartojë programe veprimi afatmesëm dhe afatgjatë, në zbatim të strategjive kombëtare dhe vendore, për zbutjen e varfërisë, integrimin e pakicave, implementimin e projekteve publike etj; (iii) Të mundësojë një partneritet të sigurtë dhe serioz për të gjitha shoqatat dhe institucionet humanitare që, nëpërmjet bashkëpunimit me projekte të

përbashkëta, të ndihmojë në uljen e varfërisë në familje dhe individë në nevojë; (iv) Të identifikojë burime materiale dhe njerëzore në komunitet për të gjetur mënyra bashkëpunimi për t'iu ardhur në ndihmë grupeve në nevojë të qytetit; (v) Të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe projekteve të ndryshme sociale; (vi) Të vlerësojë nevojat e individëve apo familjeve që kërkojnë të marrin shërbime shoqërore në përputhje me prioritetet e bashkisë dhe grumbullojë informacione për rrjetin e shërbimeve publike e private që veprojnë në territorin e bashkisë, si dhe ndihmojë aplikantët në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në nivelin e njësive administrative, nenet 54-57 kanë përcaktuar detyrat e administratorit shoqëror për njësitë administrative. Në përputhje me këto nene detyrat e tyre lidhen në masën dërmuese me programin e pagesave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar. Në këndvështirmin e shërbimeve të kujdesit shoqëror gjejmë këto detyra të njëjta për çdo njësi të lartpërmendur: (i) Sqaron qytetarët për të kuptuar të drejtat dhe obligimet e tyre në fushën e përkujdesit shoqëror; (ii) Përcakton nismën për pranimin e fëmijëve në institucionet rezidenciale publike dhe private të përkujdesit shoqëror; (iii) Bashkëpunon në rrugë institucionale me pushtetin qëndror, masmedian, si dhe me organizatat e ndryshme shqiptare ose të huaja që operojnë në fushën e kujdesit social.

Sfidat e identifikuara

1. Përshkrimet e punës në të dy nivelet e organizimit të Bashkisë nuk i përgjigjen realitetit të ri ligjor për ngritjen dhe funksionimin e sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

2. Asnjë nga pozicionet e punës nuk parashikon procese që lidhen me menaxhimin e rasteve sociale të individëve në nevojë për shërbime. Identifikimi i rasteve rezulton të jetë sporadik, më së shumti bëhet nga administratorët shoqëror, por nuk ka një sistem të ngritur dhe të koordinuar për ta bërë këtë proces të kudondodhur dhe të vazhdueshëm.

3. Mungesa e shërbimeve e bën akoma më sfiduese punën për menaxhimin e rasteve. Të gjitha rastet e intervistuara përgjatë përgatitjes së këtij Raporti dukshëm kishin nevojë për shërbime të tjera përveç ndihmës ekonomike, por mungesa e shërbimeve e bën të pamundur mbështetjen e tyre për të dalë nga varfëria apo për të shmangur përjashtimin nga tregu i punës/jeta ekonomiko sociale vendore.

4. Nevojat për trajnime. Personeli shprehu nevojën për të marrë trajnime sipas fushës së përgjegjësisë që kanë. Trajnimet duhet të fokusohen—ndër të tjera—në ndryshimet e legjislacionit.

## 4.2 Organizimi në përputhje me ligjin

Sektori i Mirëqenies Sociale dhe Përkujdesit Shoqëror përmbush funksione që lidhen me vlerësimin e nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror, ngritjen dhe funksionimin e sistemit të shërbimeve komunitare, koordinimin dhe drejtimin strategjik, mbështetjen me kapacitete dhe ndërveprimin me NJVNR. Specialistët pjesë e sektorit kryejnë funksione të ngritjes dhe funksionimit të sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror, koordinimit, planifikimit, mbështetje për administratorët shoqëror. Përmbushin gjithashtu funksione që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve, përfshirjen sociale, masat kundër dhunës në familje dhe strehimit social.

*Struktura:*
Drejtori – 1
Përgjegjësia e sektori Social – 1
Specialist për mbrojtjen sociale (PAK) – 1 specialist
Specialist për mbrojtjen sociale NE – 1 specialist
Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës – 1 specialist
Koordinatori për barazinë gjinore dhe masa kundër dhunës në familje – 1 specialist
Specialist për mbrojtjen sociale (Njesite Administrative) – 4 specialistë

## 4.3 Shërbimet ekzistuese të përkujdesit shoqëror

Në bashkinë Belsh, sipas hartëzimit më të fundit të shërbimeve sociale (UNDP, 2023), janë 3637 individë ose 10.8% e popullsisë në nevojë, ndërkohë që 1.7% e popullsisë përfiton shërbime ose pagesa cash. Në bashki janë 3419 individë përfitues të pagesave monetare dhe 57 individë përfitues të shërbimeve. Hartëzimi ka nxjerrë në pah se 1487 individë janë në situatë kritike sociale dhe ekonomike. Tabela më poshtë liston numrat sipas grupeve.

Tabela 18: Numri i individëve në situatë socio-ekonomike kritike sipas grupeve

| Grupi | Numri |
|---|---|
| **Individë në gjendje ekonomike kritike** | 1487 |
| **Fëmijë në kushte kritike** | 399 |
| **Fëmijë më aftësi të kufizuara** | 152 |
| **Të rritur më aftësi të kufizuara** | 544 |
| **Gra në kushte kritike** | 66 |
| **Të rinj** | 9 |

| | |
|---|---|
| **Të moshuar** | 75 |
| **Romë dhe Egjiptianë** | 9 |
| **Emigrantë të kthyer** | 9 |

## 4.4 Financimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

Në këndvështrimin e financimit Ligji 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" parashikon detyrimin e Bashkisë për të krijuar fondin social. Në përputhje me nenin 47 të këtij ligji fondi duhet të ngrihet me: (a) të ardhurat vjetore nga Buxheti i Shtetit; (b) financime jashtëbuxhetore nga organizata vendase apo të huaja ose persona të tjerë; (c) të ardhurat nga zbatimi i tarifave për shërbime të ndryshme të kujdesit shoqëror; (ç) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron ministria përgjegjëse për çështjet sociale; (d) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron bashkia.

Tabela më poshtë nxjerr në pah se bashkia Belsh nuk ka bërë asnjë shpenzim në lidhje me shërbimet sociale gjatë periudhës 2023-2025.

Tabela 19: Shpenzimet për programet e mbrojtjes dhe kujdesit social të Bashkisë

| PROGRAMET | VITI 2020 | VITI 2021 | VITI 2022 | VITI 2023 | VITI 2024 | VITI 2025 | % NDAJ TOT TË BUX-HETIT 2023 | % NDAJ TOT TË PRO-GRAMIT 2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Sëmundjet e aftësisë së kufizuar për të gjitha kategoritë* | 0 | 0 | 0 | 0 | - | - | 0 | 0 |
| *Ndihma ekonomike* | 0 | 0 | 0 | 0 | - | - | 0 | 0 |
| *Familja dhe Fëmije, Individë* | 0 | 0 | 0 | 0 | - | - | 0 | 0 |
| *Papunësi* | 0 | 0 | 0 | 0 | - | - | 0 | 0 |
| *Strehim* | 0 | 0 | 0 | 0 | - | - | 0 | 0 |
| **Totali** | **0** | **0** | **0** | **0** | - | - | **0** | **0** |

*Burimi: Bashkia Belsh (2023)*

Fonde të veçanta për kategoritë më sipër nuk ka patur Bashkia Belsh, përveç fondit për pagesat e NE dhe PAK—fond i cili vjen nga ministria.

Më poshtë paraqitet buxhetit i bashkisë për periudhën 2020-2025.

Tabela 20: Buxheti i bashkisë sipas burimit të financimit 000/lekë

| | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA** | **58,679** | **67,365** | **67,685** | **102,000** | **102,858** | **103,163** |
| *Të ardhura nga taksat lokale* | 32,180 | 31,311 | 32,436 | 60,980 | 59,185 | 58,874 |
| *Të ardhura nga taksat e ndara (grante)* | 6,401 | 7,518 | 7,279 | 7,120 | 7,832 | 7,978 |
| *Të ardhura nga tarifat vendore* | 18,734 | 27,056 | 26,134 | 32,120 | 34,043 | 34,496 |
| *Të ardhurat e tjera* | 1,364 | 1,480 | 1,836 | 1,780 | 1,798 | 1,815 |
| **TË ARDHURAT NGA BUXHETI QENDROR** | **772,740** | **694,977** | **702,667** | **571,080** | **466,667** | **747,772** |
| *Transferta e pakushtëzuar* | 119,458 | 150,121 | 133,542 | 146,874 | 155,280 | 165,145 |
| *Transferta e kushtëzuar për funksione të deleguara* | 235,783 | 305,102 | 308,250 | 195,462 | 103,412 | 102,643 |
| *Për projekte të veçanta* | 358,551 | 177,600 | 189,048 | 159,054 | 138,285 | 410,294 |
| *Transferta specifike* | 58,948 | 62,154 | 71,827 | 69,690 | 69,690 | 69,690 |
| **HUAMARRJA** | - | - | - | - | - | - |
| *Huamarrja afatshkurtër* | - | - | - | - | - | - |
| *Huamarrja afatgjatë* | - | - | - | - | - | - |
| **TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR** | **96,462** | **45,912** | **75,983** | **93,711** | - | - |
| *Trashëgimi pa destinacion* | 60,906 | 39,994 | 75,983 | 93,711 | - | - |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *Trashëgimi me destinacion* | 35,556 | 5,918 | - | - | - | - |
| **TOTALI I BURIMEVE BUXHETORE** | **927,881** | **808,254** | **846,335** | **766,791** | **569,525** | **850,935** |

*Burimi: Bashkia Belsh (2023)*

## 4.5 Shoqatat dhe shërbimet që ofrojnë në territorin e bashkisë Belsh

Tabela më poshtë paraqet informacion në lidhje me organizatat që ofrojnë shërbime në bashki. Në tabelë renditet organizata, viti i zbatimit, tipologjia e shërbimit, numri i përfituesve, numri i stafit që ofron shërbime, dhe financimi.

Tabela 21: Organizatat që ofrojnë shërbime në bashki

| **Nr.** | **Viti i zbatimit** *(kur ka filluar ofrimi i këtij shërbimi* | **Tipologjia e Shërbimit të kujdesit shoqëror** *(si dhe emri i shërbimit)* | **Numri i Përfituesve** | **Numri i stafit në ofrimin e shërbimit** | **Financimi** *(publik/jopublik)* | **Komentet tuaja për shërbimin** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| FGE | 2018-2023 | Projekt komunitar | 10 gra | 2, Sektori social | Donatorë | Shumë Pozitive |
| Karitasi i Jugut | 2019-2023 | Ndërtim Shtëpish | 13 objekte | 1, Sektori social | Donatorë | Shumë Pozitive |
| Diagonia agapes | 2018-2023 | Pako ushqimesh, suport ekonomik trajnime | 90 familje | 1, Sektori Social | Donatorë | Shumë Pozitive |
| A2B | 2019 - 2023 | Pako ushqimore | 60 familje | 3, Sektori Social | Donatorë | Shumë Pozitive |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| UNDP | 2019-2023 | Projekt, plan social, pako ushqimore | 100 familje | 10, Sektori Social | Donatorë | Shumë Pozitive |
| MEDPAK | 2019-2023 | Trajnime | 50 familje | 6, Sektori Social | Donatorë | Shumë Pozitive |
| FOOD BANK. | 2020-2023 | Pako ushqimore | 60 familje | 1, Sektori Social | Donatorë | Shumë Pozitive |
| Mirënjohja | 2018-2023 | Pension, mbështetje për jetimët, pako ushqimore | 50 familje | 2, Sektori Social | Donatorë | Shumë Pozitive |
| Kryqi Kuq Dega Elbasan | 2017-2023 | Pako ushqimore edhe gjithçka emergjente | 60 familje | 1, Sektori Social | Donatorë | Shumë Pozitive |
| MotërMollasit (Murgeshat) | 2019-2023 | Ndërtim të shtëpive, pako ushqimore, shërbim ambulance | 54 familje | 1, Sektori Social | Donatorë | Shumë Pozitive |
| Shoqata e Paratetraplegjikëve Dega Elbasan | 2022-2023 | Pako ushqimore | 15 familje | 1, Sektori Social | Donatorë | Shumë Pozitive |
| Fondacioni Shqipëtar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara Vorë, Tiranë (Latter day santintes charities) | 2019-2023 | Karroca invaliti per tetraplegjikët si dhe lëng te djegshëm për ngrohje të shkollave | 45 familje | 1, Sektori Social | Donatorë | Shumë Pozitive |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Fundjava Ndryshe | 2019-2023 | Pako ushqimore, ndërtim bane-sash | 120 familje dhe 3ob-jekte ndërtimi | 1, Sektori Social | Donatorë | Shumë Pozitive |
| Xhami Belsh | 2018-2023 | Pako ushqimore, pension jetimësh | 41 familje | 1, Sektori Social | Donatorë | Shumë Pozitive |
| Tjetër Vizion | 2017-2023 | Trajtim të rasteve të fëmijëve | 2 familje | 3, Sektori Social | Donatorë | Shumë Pozitive |
| Rrahman School | 2019-2021 | Pako ushqimore | 50 familje | 4, Sektori Social | Donatorë | Shumë Pozitive |
| Save the Chil-dren | 2022-2023 | Projekt social | 250-300 fëmijë (Shkolla 9-vjeçare Belsh) | 1, Sektori Social | Donatorë | Shumë Pozitive |
| World Vizion | 2020-2023 | Projekt social në subjekte publike | Plan social për rikon-struksionin e 2 kopsht-eve Belsh-Fierzë | 1, Sektori Social | Donatorë | Shumë Pozitive |
| TIKA | 2017-2019 | Projekt social | Rindërtimi i shkollës publike Belsh | 1, Sektori Social | Donatorë | Shumë Pozitive |

*Burimi: Bashkia Belsh (2023)*

## 5. Analiza SWOT

Fuqi:

- Kërkesa për shërbime sociale është në rritje.
- Domosdoshmëria e sigurimit të shërbimeve sociale për grupet më në nevojë kritike është objektiv i Programit Politik të Bashkisë.
- Bashkia Belsh, ndonëse bashki e re, është e motivuar dhe e pajisur me kapacitete njerëzore, teknike dhe profesionale, të përshtatshme për të ndërtuar dhe administruar shërbime cilësore sociale.

Dobësi:

- Mungesa e mbështetjes financiare për shërbime afatgjata.
- Pak partneritete me organizata ndërkombëtare.
- Projekte afatshkurtra të organizatave që veprojnë në territorin e bashkisë.
- Ekspertizë e pamjaftueshme lokale në drejtim të ofrimit të shërbimeve, administrimit dhe monitorimit të tyre.
- Pavarësisht decentralizimit, lidhja dhe bashkëpunimi me Shërbimin Social Shtetëror, realizohet nëpërmjet qarkut Elbasan, jo drejtëpërsëdrejti.

Mundësi:

- Reforma e Qeverisjes Vendore.
- Decentralizimi i shërbimi i sociale.
- Rritja e kompetencave të qeverisjes vendore dhe rritja e përpjekjeve për ndërgjegjësimin e tyre.

Kufizime

- Prezenca e ulët e organizatave jo-fitimprurëse në territorin e Bashkisë.
- Pesha e lartë specifike e shërbimeve që ofrohen në Elbasan e shoqëruar me lobimin e fuqishëm nga ana e qarkut Elbasan.

## 6. Fushat, qëllimet, dhe objektivat e Planit Social

### Fusha 1: Qasja në shërbime sociale

**Qëllimi 1:** Përmirësimi i qasjes në shërbime sociale përmes rritjes së numrit dhe llojeve të shërbimeve që ofrohen në territorin e bashkisë Belsh

**Fusha 2: Trajnim dhe punësim**

**Qëllimi 2:** Zbutja e papunësisë përmes ofrimit të kurseve profesionale

**Objektivi 2.1:** Kualifikimi përmes pjesëmarrjes në kurset profesionale

**Aktivitetet:**
- Vlerësimi i nevojave për ndjekjen e kurseve profesionale me fokus të veçantë personat që bëjnë pjesë në skemën e ndihmës ekonomike, emigrantët e rikthyer, dhe personat me aftësi të kufizuara.
- Krijimi i partneriteve me aktorë lokalë, rajonalë, dhe kombëtare (si Save the Children, Skills for Jobs) me qëllim ofrimin e kurseve profesionale.
- Organizimi i takimeve ndërgjegjësuese me qëllim orientimin e grupeve në nevojë drejt tregut të punës.
- Ofrimi i kurseve profesionale që mbështeten në nevojat dhe kërkesat lokale.
- Shpërndarja e informacionit rreth kurseve profesionale në të gjithë territorin e bashkisë përmes fletëpalosjeve, medias sociale, dhe medias lokale.

**Fusha 3: Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve**

**Qëllimi 3:** Ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm të mbrojtjes së fëmijëve përmes fuqizimit të kapaciteteve të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve

**Objektiv 3.1.** Rritja e kapaciteteve të Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe promovimi i rolit të tyre në territorin e bashkisë

**Aktivitetet:**
- Vendosja e Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijëve në 5 njësitë administrative të bashkisë.
- Organizimi i sesioneve të informimit në shkolla dhe institucione të tjera për promovimin e Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijëve në të gjithë territorin e bashkisë.
- Promovimi i Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe informimi i publikut rreth rolit të tyre në median sociale të bashkisë.
- Trajnimi i punonjësve rreth menaxhimit të rasteve, vulnerabilitetit, dhunës, ligjeve që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me punën e tyre, dhe rolin e Grupit Teknik Ndërsektorial.
- Organizimi i takimeve mes punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve dhe profesionistë të tjerë në nivel vendor dhe forcimi i partneriteteve.
- Shkëmbimi i eksperiencave me bashkitë ku janë ngritur Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe këto njësi dallojnë për efektivitetin e tyre.

**Fusha 4: Shërbime Parandaluese**

**Objektivi 1.1:** Rritja e numrit dhe llojit të shërbimeve që ofrohen në qendrën ditore, multifunksionale

**Aktivitetet:**
- Zgjerimi i stafit të qendrës ditore me punonjës socialë, psikologë, infermierë, dhe logopedë.
- Sigurimi i medikamenteve të nevojshme për trajtimin e fëmijëve.
- Krijimi i ambjenteve të argëtimit.
- Organizimi i takimeve me prindërit me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin rreth vështirësive që hasin fëmijët dhe rëndësisë së mbështetjes prindërore.
- Organizimi i sesioneve informuese rreth kurseve profesionale.
- Shpërndarja e informacionit në median lokale dhe sociale me qëllim informimin e komuniteteve urbane dhe rurale rreth shërbimeve që ofrohen për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe vështirësitë që hasin fëmijët.

**Objektivi 1.2:** Ofrimi i shërbimit në banesë (shërbim mjekësor, social dhe psikologjik)

**Aktivitetet:**
- Vlerësimi i nevojave për shërbim në banesë—në bashkëpunim ne stafet lokale—në të gjithë territorin e bashkisë.
- Ofrimi i shërbimit në banesë për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara si dhe çrregullime të shëndetit mendor.
- Forcimi i bashkëpunimit midis profesionistëve në qendrat shëndetësore (infermierë, punonjës socialë, psikologë, mjekë) për ofrimin e shërbimit në banesë.

**Objektivi 1.3:** Ofrimi i shërbimeve për personat që ndodhen në situatë vulnerabiliteti të shumëfishtë (për shembull, personat që jetojnë vetëm dhe kanë çrregullime të shëndetit mendor)

- Ngritja e qendrës që ofron shërbime për personat në situatë vulnerabiliteti të shumëfishtë.
- Krijimi i tipologjisë së shërbimeve që do të ofrohen në qendër.
- Krijimi i grupit të punës që do të ofrojë shërbime në qendër.
- Informimi i publikut—përmes medias lokale dhe sociale—rreth qendrës dhe shërbimeve që ofrohen në të.

**Objektivi 1.4:** Sigurimi i mbështetjes për familjet e varfra

- Ofrimi i paketave ushqimore dhe higjienike për familjet shumë të varfra.
- Qasja tek bizneset lokale, rajonale, dhe kombëtare për mbështetjen e familjeve të varfra.
- Zhvillimi i aktiviteteve brenda bashkisë për grumbullimin e veshjeve, ushqimeve, apo mjeteve të tjera për familjet e varfra.

**Qëllimi 4:** Zhvillimi i shërbimeve parandaluese

**Objektivi 4.1:** Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit rreth temave sociale dhe shërbimeve që ofron Sektori i Mirëqenies Sociale dhe Përkujdesit Shoqëror

**Aktivitetet:**

- Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit në shkolla, njësi administrative, dhe institucione të tjera mbi tema të tilla si dhuna, siguria e fëmijëve në internet, bullizmi, aftësia ndryshe.
